



PROVIMI I MATURËS NË GJIMNAZ

**KATALOGU I PËRGJITHSHËM
I MATURËS**

VITI SHKOLLOR 2010/2011

Katalogun e përgjithshëm të Maturës e përgatiti Qendra e Provimeve

PËRMBAJTJA

1. Hyrje	5
2. Mënyra e dhënies së provimit të Maturës.....	5
3. Procedura e dhënies së provimit të Maturës.....	8
4. Koha e dhënies së provimit të Maturës.....	9

1. HYRJE

Me Ligjin për gjimnazin gjimnazin ("Fleta zyrtare e RMZ", nr. 64/2 e 28.11.2002, 49/07 e 10.08.2007, dhe 45/10 e 04.08.2010) është paraparë që në fund të arsimimit në gjimnaz të jepet Provimi i Maturës. Me dhënien e Provimit të Maturës fitohet arsimimi i mesëm i përgjithshëm. Të drejtë që t'i nënshtrohet Provimit të Maturës ka ai nxënës që e ka përfunduar vitin e katërt të gjimnazit, si dhe ndjekësi i kursit të përfunduar të Maturës.

Provimi i Maturës jepet në mënyrë eksterne, kurse për realizimin e tij është e ngarkuar Qendra e Provimeve. Mënyra eksterne (e jashtme) gjatë dhënies së Provimit të Maturës do të thotë që për të gjithë nxënësit vlejnë të njëjtat rregulla të provimit, përmbajtja e provimit është e njëjtë për të gjithë, provimi i caktuar jepet të njëjtën ditë dhe në të njëjtën kohë në të gjitha shkollat e Malit të Zi. Vlerësimin e testit e bëjnë vlerësuesit e pavarur.

Provimi ekstern i Maturës, për herë të parë, në sistemin arsimor të Malit të Zi fillon të futet në vitin shkollor 2010/2011.

Qëllimi kryesor i futjes së këtij provimi është avancimi i cilësisë së arsimimit dhe vlerësimi më objektiv i të arriturave individuale të bazuara në standardet e matura të dijes.

Rregullat më të afërta për mënyrën, procedurën dhe kohën e dhënies së Provimit të Maturës në gjimnazin e përgjithshëm i sjell Ministria.

2. MËNYRA E DHËNIES SË PROVIMIT TË MATURËS

Provimi i Maturës përbëhet nga pjesa e detyruar dhe pjesa e zgjedhur.

Pjesa e detyruar përbëhet nga:

→ gjuha shqipe dhe letërsia,

→ matematika apo gjuha e parë e huaj (anglishtja, frëngjishtja, italishtja ose gjuha ruse).

Pjesën e zgjedhur e përbëjnë dy lëndë për të cilat në planin mësimor të gjimnazit është përkufizuar standardi i Maturës.

Nxënësi mund ta japë matematikën apo gjuhën e parë të huaj. Në atë rast pjesa zgjedhëse mbetet në dhënien e një lënde.

Me planin arsimor të gjimnazit të përgjithshëm lëndët vijuese mund ta përbëjnë pjesën zgjedhëse të Provimit të Maturës:

→ gjuha zyrtare si gjuhë joamtare

→ gjuha e dytë e huaj (anglishtja, frëngjishtja, italishtja ose gjuha gjermane)

→ historia

→ arti muzikor

→ arti figurativ

→ gjuha latine

→ gjeografia

→ biologjia

→ kimia

→ fizika

→ psikologjia

→ sociologjia

→ filozofia

→ informatika.

Për t'iu nënshtruar njëres nga lëndët e sipërshënuara në Provimin e Maturës, nxënësi duhet ta arrijë standardin e Maturës për atë lëndë që është paraparë me planin arsimor të gjimnazit të përgjithshëm (Të dhënat më të hollësishme mund të gjenden në broshurën e Entit për Shkollë – Koncepti i Provimit të Maturës dhe Provimit Profesional.) Standardin e Maturës së një lënde e përbëjnë njohuritë e nevojshme të cilat duhet t'i arrijë nxënësi në fund të arsimimit në gjimnaz. Standardi i Maturës është i shprehur me numrin e orëve të domosdoshme që ndjek nxënësi në mënyrë që të fitohet e drejta për dhënien e provimit të lëndës së caktuar në Provimin e Maturës.

Pasqyra e standardeve të Maturës, të disa lëndëve është dhënë me planin mësimor të gjimnazit të përgjithshëm:

	Klasa I		Klasa II		Klasa III		Klasa IV		standardi	standardi i maturës
	java	viti	java	viti	java	viti	java	viti		
LËNDËT E DETYRUESHME										
Gjuha shqipe dhe letërsia	4	140	4	140	4	40	4	128	548	548
Gjuha zyrtare si gjuhë joamtare*	2	70	2	70	2	70	2	64	274	274
Matematika	4	140	4	140	4	40	4	128	548	548
Gjuha e parë e huaj	3	105	3	105	3	105	3	96	411	411
Gjuha e dytë e huaj	2	70	2	70	2	70	2	64	274	274
Historia	2	70	2	70	2	70	2	64	274	274
Kultura fizike	2	70	2	70	2	70	2	64	274	274
Arti muzikor	1	35	→						35	140
Arti figurativ		←	1	35						
Gjuha latine					2	70			70	140
Gjeografia	2	70	2	70					140	210
Biologjia	2	70	2	70	2	70			210	310
Kimia	2	70	2	70	2	70			210	310
Fizika	2	70	2	70	2	70			210	310
Psikologjia			2	70					70	140
Sociologjia							2	64	64	140
Filozofia							2	64	64	140
Informatika	2	70							70	140
GJITHSEJ (lëndë të detyrueshme)	28		28		25		22		3539	4207
<i>Lëndët zgjedhëse të detyrueshme</i>	3	105	3	105	6	210	8	256	676	
GJITHSEJ (lëndët e detyrueshme dhe lëndët zgjedhëse)	31		31		31		30			
<i>Përmbajtjet zgjedhëse të detyrueshme</i>	1+1	35+35	1+1	35+35	1+1	35+35	1 (1)	30	240	
GJITHSEJ (lëndët e detyrueshme dhe lëndët zgjedhëse, përmbajtjet zgjedhëse të detyrueshme)	33		33		33		31		4455	
Numri i javëve të punës		36		36		36		33		

* Gjuha zyrtare si gjuhë joamtare mësohet vetëm në gjimnazet në gjuhën shqipe ku fondi i orëve të kësaj lënde i shtohet shumës së përgjithshme për të gjitha klasat, duke përfshirë edhe standardin dhe standardin e Maturës.

Gjuha amtare dhe letërsia, gjuha zyrtare si gjuhë joamtare, matematika, gjuha e parë e huaj, gjuha e dytë e huaj dhe historia janë lëndë të cilat me fondin e rregullt të orëve arrijnë standardin e Maturës. Për lëndët tjera, përveç kulturës fizike e cila nuk ka standard të Maturës, standardi arrihet me zgjedhjen e lëndës zgjedhëse gjegjëse të detyrueshme në klasën e tretë apo të katërt të gjimnazit.

Në tabelën në vazhdim është dhënë pasqyra e lëndëve zgjedhëse të detyrueshme të cilat shërbejnë për plotësimin e standardevë të Maturës të lëndëve të detyrueshme gjegjëse:

Lënda e detyrueshme	Lënda zgjedhëse e detyrueshme me të cilën plotësohet standardi i Maturës
Arti muzikor	Muzika-gjuha ime
Arti figurativ	Arti dhe komunikimet vizuale
Gjuha latine	Sintaksa e gjuhës latine
Gjeografia	Gjeografia turistike e Malit të Zi
Biologjia	Biologjia molekulare dhe gjenetika
Kimia	Biokimia
Fizika	Kapitujt e zgjedhur nga fizika
Psikologjia	Individi në shoqëri
Sociologjia	Sociologjia e kulturës
Filozofia	Logjika dhe etika
Informatika	Algoritmet dhe programimi

Për të gjitha lëndët, të cilat jepen në Provimin e Maturës, janë hartuar katalogët e provimit të lëndës. Në katalogët në fjalë janë dhënë të gjitha informacionet lidhur me dhënien e lëndës së caktuar.

Në katalogun e provimit janë cekur qëllimet e përgjithshme të provimit, është përshkruar struktura e provimit dhe përmes formës së programit të provimit me qëllime është thënë përmbajtja e lëndës që do t'i nënshtrohet provimit.

Është dhënë edhe shembulli i testit me skemë të hollësishme për vlerësim, si dhe literature e nevojshme për përgatitjen e suksesshme të provimit.

Të gjitha lëndët në Provimin e Maturës jepen me shkrim, d.m.th. me plotësimin e testit.

Kandidatit me nevoja të posaçme, i cili ka vendimin për orientim i përshtatet mënyra, procedura dhe koha e zgjatjes së dhënies së disa provimeve, në kuadër të afatit të paraparë dhe orarit të dhënies së provimeve.

3. PROCEDURA E DHËNIES SË PROVIMIT TË MATURËS

Qendra e Provimit është institucion që bën punët profesionale, zhvillimore, organizative, administrative dhe punët tjera që lidhen me realizimin e Provimit të Maturës.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës formon komisionin i cili do ta përcjellë zbatimin e Provimit të Maturës dhe që do të sigurojë cilësinë në nivel të shtetit. Ky komision bashkërendon, harmonizon dhe merr pjesë në përgatitjen dhe zbatimin e Provimit të Maturës dhe përkujdeset për sigurimin e kushteve të njëjta për punë të të gjithë pjesëmarrësve në procedurë, si dhe për cilësinë e përmbajtjes dhe procedurës së Provimit të Maturës.

Drejtori i gjimnazit formon komisionin prej pesë anëtarësh për përgatitjen e Provimit të Maturës. Ky komision ka për detyrë të sigurojë kushtet për zbatimin e Provimit të Maturës në shkollë.

Koordinatori i shkollës është person i cili i bashkërendon veprimtaritë që kanë të bëjnë me Provimin e Maturës në mes të Qendrës së Provimeve dhe gjimnazit. Ai organizon punën e administruesve të testit e merr dhe e kthen të gjithë materialin e provimit në Qendrën e Provimeve. Aktivitetet e koordinatorit të shkollës më hollësisht janë përcaktuar me Udhëzimin e koordinatorit të shkollës, që e ka përgatitur Qendra e Provimeve.

Administruesit e testit janë ata të cilët e sigurojnë respektimin e rregullave në mjediset ku zhvillohet provimi. Administruesit e testit nuk mund të caktohen të bëjnë kujdestari në shkollën e tyre, si dhe në lëndën e tyre ose nga lënda e grupit të ngjashëm. Veprimtaritë e tyre janë plotësisht të caktuara me udhëzimin e administruesit të testit që e ka përgatitur Qendra e Provimeve.

Qendra e Provimeve bën orarin e kandidatëve dhe administruesve të testit nëpër mjediset ku do të zhvillohet provimi. Ky orar është fshehtësi e punës derisa të shpallet, 60 minuta para fillimit të provimit.

Kandidatët që do t'i nënshtrohen provimit me veten duhet të kenë një dokument personal me fotografi, në bazë të të cilit do të bëhet identifikimi i tyre.

Kandidati është i detyruar të jetë para vendit ku do të zhvillohet provimi të paktën 30 minuta para fillimit të tij. Gjithashtu është i obliguar që t'i respektojë rregullat e sjelljes që do t'ia kumtoi administruesi i testit para fillimit të provimit. Futja e telefonave celularë dhe pajisjeve tjera elektronike në mjediset ku do të zhvillohet provimi nuk është e lejueshme.

Kandidati nuk mund ta braktis vendin ku zhvillohet provimi gjatë 30 minutave të parë të provimit. Tre kandidatët e fundit duhet ta lëshojnë së bashku klasën ku është zhvilluar provimi. Kandidati i cili e prish rendin e caktuar në provim së pari do të paralajmërohet, e nëse vazhdon me sjelljen që bie ndesh me rregullat e sjelljes, edhe do të përjashtohet nga provimi, me çka do të konsiderohet se provimin nuk e ka dhënë.

4. KOHA E DHËNIES SË PROVIMIT TË MATURËS

Provimi i Maturës mund të jepet në afatin e qershorit, gushtit dhe të janarit. Provimi i Maturës dhe Provimi Profesional do të zhvillohen, sipas rregullit, prej 1 deri me 15 qershor të vitit 2011 (kalendari shkollor për vitin 2010/2011 neni 5). Orari i provimit të lëndëve të detyrueshme dhe të lëndëve zgjedhëse do të bëhet pas përcaktimit përfundimtar të kandidatëve për lëndët që do t'i japin në Provimin e Maturës.

Nxënësit përcaktohen për lëndët që do t'i japin në Provimin e Maturës gjatë periudhës së parë klasifikuese të vitit të katërt. Gjimnazet janë të detyrueshme që Qendrës së Provimeve t'ia dorëzojnë të dhënat për përcaktimin e nxënësve më së largëti deri me 1 dhjetor të vitit në vazhdim.

Nxënësit përcaktimin e tyre mund ta ndryshojnë deri në ditën e dërgimit të të dhënave përfundimtare Qendrës së Provimeve. Gjimnazet duhet që të dhënat përfundimtare t'ia dorëzojnë Qendrës së Provimeve më së largëti deri me 10 shkurt të vitit mësimor në vazhdim, për afatin e qershorit, respektivisht 35 ditë para fillimit të afatit të gushtit dhe afatit të janarit për ato afate.

Pas shpalljes së provimeve përmirësuese për nxënësit e vitit përfundimtar, në afat prej dy ditësh, gjimnazi është i obliguar që t'ia dorëzojë Qendrës së Provimeve regjistrin e nxënësve të cilët nuk kanë të drejtë ta japin Provimin e Maturës.

Për dhënin e Provimit të Maturës kandidatët i dorëzojnë gjimnazit një para fletëparaqitje, në të cilën shënojnë emrat e lëndëve të detyrueshme dhe lëndëve zgjedhëse që do t'i japin në provim.

Pas fitimit të kushteve për dhënin e Provimit të Maturës, kandidatët i paraqesin gjimnazit fletëparaqitjen për provim.

Kohëzgjatja e provimit nga disa lëndë është e caktuar me katalogun e provimit të lëndës dhe nuk mund të jetë më e gjatë se 180 minuta.

Gjatë një dite kandidati mund t'i nënshtrohet vetëm një provimi nga lënda e detyrueshme.

Vlerësimin e çdo testi e bëjnë dy vlerësues të trajnuar, të pavarur njëri nga tjetri. Nëse ka ndonjë dallim të madh në vlerësim, notën përfundimtare e sjell vlerësuesi i tretë-vlerësuesi kryesor.

Suksesi nga disa lëndë vlerësohet me nota prej 1 deri në 5, kurse suksesi i përgjithshëm nga disa lëndë llogaritet si mesi aritmetik.

Notat shkëlqyeshëm (5), shumë mirë (4), mirë (3) dhe mjaftueshëm (2) janë nota pozitive dhe kandidati e ka kaluar Provimin e Maturës nëse nga të gjitha lëndët është vlerësuar me notë pozitive. Nëse kandidati nga një ose më shumë lëndë është vlerësuar me notën e pamjaftueshme (1), ai nuk e ka kaluar Provimin e Maturës dhe dërgohet në provimin përmirësues në afatin e ardhshëm të provimit.

Kandidati i cili nuk është i kënaqur me notë ka të drejtë ankese Qendrës së Provimeve, në afat prej 24 orëve nga koha e shpalljes së rezultateve. Gjithashtu, kandidati ka të drejtë ta shohë testin e tij dhe mënyrën e formimit të notës. Qendra e Provimeve do t'ia dërgojë gjimnazit rezultatet përfundimtare të Provimit të Maturës për çdo kandidat, veç e veç.

Gjimnazi çdo kandidati që e ka kaluar Provimin e Maturës ia jep diplomën për Provimin e dhënë të Maturës.

Shënime

A series of horizontal dotted lines for taking notes.



qendra e provimeve

**MASA E
VËRTETE E
NJOHURIVE**

Vako Gjuroviq p.n., 81 000 Podgoricë
ic@iccg.co.me, www.iccg.edu.me